



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

AD/GJTHPR/05/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga avokati R.K, ndaj gjyqtares N.J , për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 09.02.2022 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. R.K ndaj gjyqtares N.J për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Avokati R.K me datë 14.01.2022 ka paraqitur ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N.J në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me datë 21.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës av. R.K ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares N.J për shkak të pretendimeve se në lëndën P.nr.3269/21 (2021:016294), gjyqtarja nuk ka caktuar me kohë seancën e shqyrtimit fillestar, pasi i pandehuri ishte në paraburgim dhe për këtë shkak se seanca duhet të caktohej jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Tutje, parashtruesi i ankesës ka theksuar se me datë 26.10.2021 av. F.K ka pranuar ftesë nga gjyqtarja N.J për seancën e datës 01.11.2021, madje, caktimi i seancës fillestare i është komunikuar edhe parashtruesit në zyrën e gjyqtares, edhe në praninë e prokurores M.L. Tutje, sipas pretendimeve ankimore, me datë 29.10.2021, përmes telefonit zyrtar është njoftuar av. F.K se gjykimi i caktuar më herët, për datën 01.11.2021 nuk do të mbahet pa dhënë asnjë arsyetim. Për më tepër, sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtarja e rastit ka ndërhyrë në veprimet hetimore të prokurorëve, me qëllim të ndikimit në veprimet e tyre lidhur me këtë rast.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N.J.

Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore lidhur me pretendimet ankimore se, seanca e shqyrtimit fillestar në rastin PKR.nr.614/21 nuk është caktuar me kohë, dhe brenda afatit ligjor prej 15 ditëve nga ngritja e aktakuzës, pasi i pandehuri ishte nën masën e paraburgimit, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë sepse nga shkresat e lëndës rezulton se, me datë 11.10.2021 lënda është pranuar në gjykatë, ku fillimisht lënda iu është ndarë në punë gjyqtares F.D, me datë 13.10.2021 gjyqtarja F.D ka bërë kërkesë për përjashtim nga lënda, pasi e njëjta ka vepruar në procedurën paraprake, me datë 15.10.2021 pas vendosjes për përjashtim të gjyqtares F.D, lënda në bazë të shpërndarjes automatike i është ndarë në punë gjyqtares N.J .

Pas pranimit të lëndës nga gjyqtarja N.J, e njëjta ka caktuar seancën me datë 01.11.2021, mirëpo në ndërkohë me datë 29.10.2021 e njëjta e ka anuluar seancën e datës 01.11.2021 me arsyetim se aktakuza e ushtruar në shenjë PP.I.nr.67/21 ka të meta faktike dhe juridike dhe duhet kërkuar mendim nga zyra e Kryeprokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale.

Me datë 29.10.2021, gjyqtarja N.J ka dërguar Njoftimin për Kryeprokurorin e Shtetit, Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe Prokuroren e rastit, se aktakuza PP.I.nr.67/2021 e datës 11.10.2021 kundër të akuzuarit S.K është për shkak të veprës penale Vrasje nga pakujdesia nga neni 175 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kurse Aktvendimi për fillimin e hetimeve PP.I.nr.67/2021 i datës 28.01.2021 kundër të pandehurit S.K ishte për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3 të KPRK-së dhe Mbajtja në kontroll dhe ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe se gjyqtarja pas analizimit të aktakuzës ka gjetur se ka paqartësi në mes provave në shkresa të lendes dhe aktakuzës dhe për këtë i duhet Mendimi i Kryeprokurorit të shtetit, Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe prokurores së rastit, lidhur me përshkrimin faktik dhe juridik të veprës penale, me qëllim të parapërgatitjes së gjykatës për caktimin e shqyrtimit fillestar dhe mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore. Po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se, me datë 15.11.2021, gjyqtarja N.J pas pranimit të përgjigjes nga Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, është shpallur jo kompetente dhe ka kërkuar që kjo lëndë të bartet në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj gjykate, si departament me kompetencë lëndore.

Andaj duke pasur parasysh se gjyqtarja e rastit, në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime procedurale që nga momenti i pranimit të lëndës, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore se gjyqtarja e rastit ka ndërhyrë në veprimet hetimore të Prokurorisë me qëllim të ndikimit në veprimet e tyre, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.9 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/05/22, me datë 09.02.2022

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë